



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 31384 Prot.
12

Patos më, 27 / 12 / 2023

VENDIM

Nr. 80, datë 18.12.2023

**PËR MIRATIMIN E KALENDARIT TË PËRGATITJES SË PROJEKT BUXHETIT
AFATMESËM 2025-2027 DHE PROJEKT BUXHETIT VJETOR 2025.**

Bazuar në pikën 1 neni 41, shkronja "dh" neni 54 të ligjit 139/2015 datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", në ligjin nr.9936 datë 26.06.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë", nenin 33 të ligjit 68/2017 " për Financat e Vetëqeverisjes Vendore", Udhëzimi nr.23 datë 30.07.2018 "Për Proçedurat standarte të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm të njesive të Vetëqeverisjes Vendore", Këshilli i Bashkisë i mbledhur më datë 18.12.2023 pasi analizoi projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Menaxhimit Strategjik,

VENDOSI:

1. Të miratojë kalendarin e përgatitjes së projekt Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027 dhe projekt Buxhetin Vjetor 2025, sipas lidhjes nr.1 bashkëngjitur, pjesë përbërse e këtij vendimi
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Grupi i Menaxhimit Strategjik.
3. Ky vendim u shpall në datën 27.12.2023.
4. Vendimi hyn në fuqi 10 dite pas shpalljes.



KRYETARI
Armand Ahmetaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILI I BASHKISË PATOS

Lidhja nr.1

KALENDARI I PËRGATITJES SË PROJEKT PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM
2025-2027 DHE PROJEKT BUXHETIT 2025

N.R	Struktura Përgjegjëse	Veprimi Përkates	Periodha
1	Kryetari i NJQV-së,GMS	Shpërndan kalendarin e programit te projekt Buxhetit Afatmesëm 2025-2027 tek të gjitha Njësitë shpenzuese (pika 56 USPBA).	Deri në 15.01.2024
2	Kryetari i NJQV-së,GMS	Paraqet për shqyrtim dhe miratim raportin e vlerësimit të të ardhurave PBA 2025-2027, në këshillin Bashkiak (pika 57 USPBA).	29.01.2024
3	Këshilli Bashkiak Patos	Miraton raportin e vlerësimit të të ardhurave PBA 2025-2027. (pika 50 USPBA).	Deri në 01.03.2024
4	Kryetari i NJQV-së,GMS	Përgatitja dhe dërgimi i Tavanëve përgatitore të shpenzimeve të projekt Buxhetit Afatmesëm 2025-2027 në këshillin Bashkiak(pika 62 USPBA).	Brenda datës 15.03.2024
5	Këshilli Bashkiak Patos	Miraton Tavanet përgatitore të shpenzimeve të projekt Buxhetit Afatmesëm 2025-2027 (pika 63 USPBA).	Brenda datës 15.03.2024
6	Kryetari i NJQV-së,GMS,Zyra Juridike	Miraton udhëzimin e Përgatitjes së buxhetit te Njësisë së Qeverisjes Vendore dhe e shpërndan tek D.P, njësitë shpenzuese së bashku me Tavanët përgatitor të miratuar K.B.(pika 64 USPBA).	Brenda datës 19.03.2024
7	EMP,Drejtoritë e Bashkisë Patos	Përgatitin kërkesat buxhetore	20.03.2024-23.04.2024
8	K.B, DEMP, Drejtorët e Bashkisë Patos	<ul style="list-style-type: none">Zhvillojnë takime konsultative me shoqërinë civile dhe grupet e interesit për PBA 2025-2027 sipas Uz.Vjetore	27.04.2024-28.04.2024
9	EMP,Drejtoritë e Bashkisë Patos	Dorëzimi i kërkesave buxhetore në drejtorinë e burimeve njerëzore	28.04.2024-29.04.2024
10	Njësia Përgjegjëse për buxhetin në Bashki	Kryejnë analizat e kërkesave buxhetore	04.05.2024-14.05.2024
11	Kryetari i NJQV-së Nepunesi Autorizues	Organizon seancat dëgjimore me banorët grupet e interesit ,shoqërinë civile	17.05.2024-26.05.2024
12	Kryetari i NJQV-së,GMS	Përpilon draftin e fazës së parë të PBA-së 2025-2027	27.05.2024-28.05.2024
13	Kryetari i NJQV-së,GMS	Dërgon pranë ministrisë së Financave projekt dokumentin e PBA-se 2025-2027	Brenda datës 01.06.2024
14	Ministria e Financave	Dërgon komente,një raport me mendime mbi projekt dokumnetin e PBA-së 2025-2027	Deri ne 18.06.2024
15	Njësia Përgjegjëse për buxhetin në Bashki	Reflekton komentet e Ministrisë së Financave për Projekt Dokumentin e PBA-së 2025-2027	25.06.2024

16	Kryetari i NJQV-së,GMS	Paraqet për miratim projektin e parë të PBA-së 25-27	25.06.2024
17	Këshilli Bashkiak Patos	Shqyrton dhe miraton projektin e parë të projekt Buxhetit Afatmesëm 2025-2027	Deri në 30.06.2024
18	Kryetari i NJQV-së,Drejtoria e Informacionit	Marin masat për publikimin e Projektit të parë të Projekt Buxhetit Afatmesëm 2025-2027	Deri në 05.07.2024
19	Kryetari i NJQV-së,GMS Këshilli Bashkiak Patos	Përgatit dhe paraqet për miratim në K.Btavanët përfundimtar të PBA-së 2025-2027(pika 79 USPBA) Miraton Tavanet përfundimtare të PBA-së 2025-2027	Deri në 15.07.2024 19.07.2024
20	Kryetari i NJQV-së,GMS,Zyra Juridike	Miraton udhëimin plotësues të PBA-së dhe e shpërndan tek D.P, njësitë shpenzuese së bashku me Tavanët përfundimtar të miratuar K.B (pika 80 USPBA)	26.07.2024
21	Njësitë shpenzuese të Bashkisë Patos	Përgatisin kërkesat buxhetore të rishikuara në përputhje me tavanet përfundimtare të PBA-së .Dorëzimi i tyre në Bashki(sekretari i GMS)	26.07.2024-01.09.2024
22	Njësia Përgjegjëse për buxhetin në Bashki	Kryejnë analizat e kërkesave të rishikuara buxhetore	02.09.2024-14.09.2024
23	EMP Administratoret e njësive administrative	Strukturimi dhe paraqitja e PBA-së sipas politikave vendore,programeve buxhetore,funksioneve të programeve <ul style="list-style-type: none"> • Duke ripërcaktuar/definuar/apo rritur objektivat. • Duke përcaktuar treguesit për matjen e objektivave. • Situatën e pritshme të treguesve deri në fund të vitit 2024. • Situatën e synuar për vitet përkatësisht 2025-2026-2027. • Përgatitja e propozimeve për ndryshime të paketës fiskale. 	Brenda datës 02.09.2024
24	EMP,Kryetar,Zv Kryetar	Konsultimi dhe miratimi i kuadrit të PBA-së, për secilin program me nivelin drejtues N/Kryetar dhe Kryetar ,sipas varësisë së përcaktuar në strukturë.	02.09.2024-14.09.2024
25	EMP, Zv Kryetar	Përgatitja e drafit për publikim dhe afishim në web për konsultim publik	Brenda datës 14.09.2024
26	EMP Administratoret e njësive administrative,Zv Kryetar	Konsultimi i ndryshimeve të paketës fiskale përmes <ul style="list-style-type: none"> • webit ,komunikim zyrtar • Diskutimeve • Dëgjësive publike me banorët ,grupet e interesit ,shoqërinë civile,anëtarët e këshillit bashkiak.(kalendari i diskutimeve do të bëhet publik) 	02.09.2024-14.09.2024
27	Kryetari i NJQV-së	Dërgohet në Ministrinë e Financave Dokumenti i PBA-së i rishikuar ,i miratuar nga K.B së bashku me një informacion mbi rekomandimet e dhëna nga Minsitria e Financës gjatë fazës së Parë	Brenda datës 14.09.2024

28	Ministria e Financave	Organizon seanca konsultimi me njësité e Q.Vendore.Sipas rastit M.F dërgon mendimet përfundimtare për tu reflektuar në dokumentin final të PBA-së.	Deri në 20.10.2024
29	Ministria e Financave	Sipas rastit M.F dërgon mendimet përfundimtare për tu reflektuar në dokumentin final të PBA-së dhe Buxhetit Vjetor	Brenda datës 20.10.2024
30	EMP	Konsolidimi i kërkesave buxhetore: 1. Për aktivitete në vazhdim apo të përvitshme për secilin vit. 2. Për aktivitete të tjera duhen të detajohen vetëm aktivitetet e vitit .	20.10.2024-03.11.2024
31	GMS	Vlerësimi dhe miratimi i projekt Buxhetit Afatmesëm 2025-2027 dhe Projekt Buxhetit Vjetor 2025 nga GMS.	07.11.2024
32	Njësia Përgjegjëse për buxhetin në Bashki	Hartimi i P/Vednimit dhe relacionit përmbledhës të projekt Buxhetit Afatmesëm 2025-2027 dhe Projekt Buxhetit Vjetor 2025. (secila drejtori harton relacionin për fushën e vet të përgjegjësisë sipas strukturës në modelin përkatës.Drejtorja e Burimeve Njerëzore dhe njësia e buxhetit ne bashki të punojë për lidhjen pjesëve dhe përpilimin e relacionin shpjegues,pjesë e parë e dokumentit të buxhetit.)	07.11.2024-23.11.2024
33	Drejtorja e Burimeve Njerëzore dhe Informacionit	Formatim,printim dhe lidhja e dokumentit	23.11.2024-30.11.2024
34	Kryetari i NJQV-së	Dërgim i projekt vendimit dhe dokumentit të projekt Buxhetit Afatmesëm 2025-2027 dhe Projekt Buxhetit Vjetor 2023 në Këshillin Bashkiak.	Jo më vonë se data 30.11.2024
35	Këshilli Bashkiak Patos	Shqyrtimi nga këshilli Bashkiak :: • Shqyrtimi nga ana e Këshillit Bashkiak me grupet e interesit dhe komunitetit të projekt Buxhetit Afatmesëm 2025-2027 dhe Projekt Buxhetit Vjetor 2025. • Miratimi i dokumentit Projekt Buxhetit Vjetor 2025 ,të projekt Buxhetit Afatmesëm 2025-2027.	Gjatë muajit dhjetor 2024 Jo më vonë se data 23.12.2024
36	Kryetari i NJQV-së	Publikimi i dokumentit të plotë të Miratimit te Buxhetit vjetor 2025, dhe Afatmesëm 2025-2027.	Jo më vonë se data 31.12.2024
37	Kryetari i NJQV-së	Dërgim në Ministrinë e Financave kopjen e plotë të projekt Buxhetit Afatmesëm 2025-2027 dhe Projekt Buxhetit Vjetor.	Jo më vonë se 5 ditë kalendarike nga data e miratimit nga Këshilli Bashkiak
38	Kryetari i NJQV-së	Hartor strukturën e programeve buxhetore dhe ngre ose ndryshon GMS	31.12.2024



KRYETARI
Armand Ahmetaj

Adresa: Lagja "Nafëtar" Rruga "Gnaza", Patos